



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 63.
Prishtinë, më 11.03.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Elmi Reçica dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, gazetarë e Kohës Ditore - Blerta Aliu, gazetarë Kosovapres - Teuta Gashi, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tisma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, praktikantë nga UNDP -ja Eldin Buzgovic

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.02.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, me amendamente të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
4. **Shqyrtimi i amendamentit plotësues të Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, me amendamente të komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamente të komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;
7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, me amendamentet e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
9. Të ndryshme.
 - 9.1, Informim lidhur me zëvendësimin e mandatit të përfaqësuesit të komunitetit Ashkali dhe Egjiptian dhe Goran në Komision,
 - 9.2 Formimi i grupit punues për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së implemenitimit të strategjisë për integrimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, nga marrëveshja e Stabilizim- Asocimit

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi – në fjalinë e tij tha se për arsye të angazhimeve Parlamentare nuk është arritur të përkthehet procesverbali në gjuhën serbe i datës 26.02.2013, andaj propozoi që i njëjti të procedohet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, me amandamente të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesi – paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Petar Miletic –pajtohet me gjithë procesin e shqyrtimit të projektligjit për kontrollin e duhanit. Ai theksoi se ka dhënë amendament në nenin 6, paragrafi 1, që të fshihet fjala ‘përfundim i duhanit’, dhe se i njëjti është miratua nga komisioni Funksional.

Me që nuk kishte vërejte, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i amendamentit plotësues i Komisioni Funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit;**

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim amendamentin plotësues të Komisioni Funkcional në Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni shqyrtoi amandamentin plotësues të Projektligjit për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit nr.04/L-145 dhe vlerësoi se dispozitat e projektligjit nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, me amendamente të komisionit funksional për Buxhet dhe Financa

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamente të komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-185 për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- V. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- VI. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

9. Të ndryshme.

9.1. Informim lidhur me zëvendësimin e mandatit të përfaqësuesit të komunitetit Ashkali dhe Egjiptian dhe Goran në Komision.

Kryesuesi – foli për përbërjen e strukturës së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, se një anëtarë përfaqëson komunitetin Ashkali, Egjiptas dhe Goran.

Njoftoi komisionin, se në bazë të marrëveshjes për ndarjen e mandateve ndërmjet përfaqësuesve të tyre në Komision, janë krijuar kushtet e parapara për zëvendësimin e mandatit të anëtarit Xhevdet Neziraj me anëtarin Mursel Halili, për periudhën një vjeçare.

9.2 Formimi i grupit punues për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së implemenitimit të strategjisë për integrimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, nga marrëveshja e Stabilizim- Asocimit

Kryesuesi – ishte i mendimit se Komisioni do të kontribuojë në mbikëqyrjen e strategjisë, kur bëhet fjalë për progresin e integritit të komunitetit romë, shkali dhe egjiptian për periudhën 2009-2015 ,

***Xhevdet Neziraj** – diskutoi për të metat e strategjisë nga se nuk po implementohet në masë të duhur dhe kërkoi që Qeveria të jetë më transparente kur bëhet fjalë për integrimin e komunitetit rom, shkali dhe egjiptian që jetojnë në Kosovë.*

Ai propozoi që në fazën e parë të mbikëqyrjes së strategjisë të organizohet Dëgjimi Publik, ku do të informohemi nga akterët për të arriturat, përfshirë këtu arsimimin, numrin e të punësuarve etj.

Kryesuesi - konstatoi se Komisioni mori qëndrim se në bazë të Planit të Veprimit për mbikëqyrjen e strategjisë për integrimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, të formohet grupi punues në këtë përbërje:

- Albert Kinolli
- Lumnije Morina
- Rasim Demiri
- Jelena Bontic
- Xhevdet Neziraj

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic